



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:146246

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05640358

C.nr.1375/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Civil, gjyqtari Vegim Maloku, në çështjen juridike-kontestimore të paditëse R.D. etj që të gjithë nga fshati B. Komuna e P. të cilët i përfaqëson Mustafë Maloku avokat në Pejë, kundër të paditurve D.B. etj, që të gjithë nga fshati B. Komuna e Pejës, e të cilët i përfaqëson N.A. nga fshati B. Komuna e P., me bazë juridike vërtetim pronësie, vlera e kontestit 1,000.00 euro, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe publik, në prezencën e të autorizuarit të paditësve dhe të autorizuarit të të paditurve, me datën 24.04.2024 mori kurse me datën 30.04.2024 përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

-në bazë të pohimit-

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësve R.D. etj që të gjithë nga fshati B. Komuna e P., NË TËRËSI SI E BAZUAR.

- II. VËRTETOHET se paditësve R.D. etj që të gjithë nga fshati B. Komuna e P., u takon e drejta e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues me nga 1/3 të pjesës ideale të 4/6 të paluajtshmërisë 00...-1 në sipërfaqe prej 8064 m2 ZK B. dhe 1/3 të pjesës ideale të 4/6 të paluajtshmërisë 00...-1 në sipërfaqe prej 4433 m2 ZK B. dhe DETYROHEN të paditurit D.B. etj, që të gjithë nga fshati B. Komuna e Pejës, që paditësve t'ua pranojnë të drejtën e pronësisë si në pikën II të këtij dispozitivi dhe të lejojnë që të njëjtit të regjistrohen si pronar të këtyre pjesëve ideale të përshkruara në pikën II të

këtij dispozitivi, në Zyrën Kadastrale në Komunën e Pejës, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcënim të përbarimit.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësit në këtë gjykatë, me datë 30.10.2020 kanë parashtruar padi kundër të paditurve me bazën juridike vërtetim pronësie. Në padi kanë theksuar se paraardhëset ligjore të të paditurve e tani të ndjera D.M. etj, ishin bashkë pronare të pronës së paluajtshme në fshatin B., konkretisht të ngastrave ../1 dhe ../1 ZK Brestovik. Të njëjtat, për të gjallë të tyre, u kishin shitur pjesët e tyre ideale e të cilat ndaheshin me bashkëpronarë të tjerë, këtu paditësve si fqinjë dhe bashkëpronarë, ku të njëjtit janë bashkë pronarë të këtyre parcelave me nga 1/18 në pjesë ideale. Paditësit kanë përmbushur në tërësi çmimin kontraktues dhe janë në posedim të këtyre pjesëve. Të paditurit e kanë shqyrtuar trashëgiminë e nënave të tyre, me qëllim që paditësve të ua bartin pjesët e tyre të pronësisë. Tutje, padinë e kanë precizuar me parashtrësën e dorëzuar në seancën e datës 21.02.2024 të cilën gjykata e ka lejuar po ashtu në këtë seancë.

Të paditurit, përmes të autorizuarit të tyre N.A. kanë paraqitur përgjigje në padi, me të cilën e kanë pohuar në tërësi kërkesëpadinë e palës paditëse, sepse e njëjta është në tërësi e bazuar dhe se para 30 viteve, këto pjesë i kanë blerë palët paditëse dhe kanë paguar në tërësi çmimin kontraktues. Më tutje, padinë dhe kërkesën e saj e kanë pohuar në vazhdimësi të tërë procesit si dhe pas precizimit të kërkesëpadiës si dhe në fjalën përfundimtare.

Gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar duke qenë se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishin kontestuese faktet vendimtare të çështjes dhe se të paditurit e kanë pohuar kërkesëpadinë.

Gjykata nga shqyrtimi i gjithmbarshëm i çështjes, edhe përkundër pohimit të kërkesëpadiës nga të paditurit, gjykata ka shtyrë marrjen e aktgjykimit në bazë të pohimit, kurse sipas propozimit të paditëseve me qëllim të verifikimit dhe marrjes së njoftimeve të duhura në kuptim të nenit 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka caktuar seancën e vendshiqimit dhe nxjerrjen e provës përmes ekspertizës së gjeodezisë.

Gjykata pas analizimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, thëniet në padi dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga të paditurit dhe deklarimeve gjatë shqyrtimit, ka gjetur se janë në harmoni me njëra tjetrën dhe me pohimin e palës së paditur, nga të cilat vërtetohen faktet relevante se palët mund të disponojnë me kërkesat e tyre, pasi që fillimisht vërtetohet se palët e paditura në bazë të certifikatës së pronës së datës 14.12.2023 për parcelat ...-1 dhe...-1 janë bashkëpronarë me nga 1/6 të pjesëve ideale të këtyre parcelave, kurse paditësit bashkëpronar me nga 1/18, nga rrjedh se të paditurit mund të disponojnë me të drejtat e tyre dhe se këto disponime nuk janë në kundërshtim me nenin 3 të LPK-së, ku kërkesën e paditësve e kanë pohuar përmes të autorizuarit të tyre, i cili ka vepruar sipas urdhëresës së gjykatës duke paraqitur autorizim të noterizuar nga ta paditurit e prej të cilëve në mënyrë shprehimore është autorizuar që të pohojë kërkesëpadinë sipas çështjes që është objekt kontesti.

Gjykata pas pohimit të kërkesëpadisë nga ana e të paditurve, konstatoi se kërkesa është e disponueshme për palët, prandaj në kuptim të nenit 148 paragrafi 1 të Ligjit të procedurës Kontestimore (LPK) – me të cilin përcaktohet se “ *në qoftë se i padituri deri në përfundim të shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesën (aktgjykimi në bazë të pohimit)*”- vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mori bazuar në nenin 450 të LPK- së, pasi që palët nuk i kanë kërkuar shpenzimet.

Mbi bazën e parashtrimeve të mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143 dhe 148.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:146246, C.nr.1375/20, **30.04.2024**

G j y q t a r i:
Vegim Maloku

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët mund të ushtrojnë ankese në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate. Në kuptim të nenit 181 par.2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.